

*TV Arberia*, 19 mars 2003

## **Interviste me Kryetarin e Prezences se OSBE-se ne Shqiperi, Ambasadorin Osmo Lipponen**

**P: Si do ta perkufizonit Shqiperine persa i takon klimes politike, zhvillimit,dhe vullnetit politik duke u ndalur vecanerisht tek ligji per kthimin e pronave dhe ligjin zgjedhor?**

Shqiperia eshte nje vend ne tranzicion dhe une vertet deshiroj qe gjerat te ecin per mire. Keto ceshtje qe permendet ju jane nje shembull i mire e nje lloji te ri te vullnetit politik. Procesi qe kemi pare dhe qe eshte duke u zhvilluar ne diskutimet rreth ligjit elektoral eshte shume konstruktiv dhe reflekton dicka te re kur e krahason me disa vite me pare ne politiken shqiptare. Ky process ka krijuar nje lloj te ri besueshmerie megjithese ende eshte paksa i lekundur. Une shpresoj qe kjo besueshmeri do te reflektohet edhe ne diskutimin qe po zhvillojme per ligjine e kthimit te pronave. Ne se keto dy procese ecin perpara dhe ne menyre pozitive kjo gje do te kete nje efekt shumues ne politike. Nje gje e cila nevojitet ende eshte te paturit me shume transparence ne administrate si dhe ne sistemin politik.

**P: Cfare duhet te beje shpejt dhe mire Shqiperia per te ecur perkrah vendeve te tjera qe jane ne procesin e integritimit Evropian?**

Komisioni Evropian eshte institucioni i duhur per t'iu pergjigjur kesaj pyetjeje, por meqe une kam qene i perfshire ne nje proces integrimi ne Finlande dhe duke qene me detyre ne Kroaci, vend qe ka qene ne nje proces te ngjashem Asociim Stabilizimi si Shqiperia, dua t'i kthehem asaj qe thashe ne fund te pyetjes se pare per punen e transparences se administrates. Integrimi ne shumicen e rasteve kerkon nje shoqeri te hapur. Te drejtat dhe lirite qytetare dhe mundesia per te marre informacion jane disa nga shtyllat e Bashkimit Evropian.

**P: Si vleresohet nga ju rreshtimi i Shqiperise perkrah SHBA-ve dhe Britanise se Madhe ne ceshtjet e Irakut?**

Eshte e drejta e cdo vendi sovran dhe te pavarur qe te vendose vete mbi politiken e jashtme.

**P: A rrezikon Shqiperia integrimin ne Evrope per shkak te ceshtjes se Irakut per te cilen edhe vete vendet Europiane kane kontradikta te forta mes tyre?**

Jo nuk mendoj keshtu sepse zgjedhja e opinioneneve brenda vendeve evropiane dhe vendeve te Bashkimit Evropian varion nga kundra ose pro e deri tek pozicioni asnjanes. Kjo eshte pjese e Bashkimit Evropian. Koordinimi i politikave se jashtme eshte pjese e fundit e politikave te bashkuara evropiane dhe vendet e vecanta kane opinionet e tyre te forta. Kjo gje mund te ndikojte ne perpjekjet qe behen brenda Bashkimit Evropian per te shkuar ne hapin tjeter te reformave te tyre te brendshme.

**P: Cili është roli i OSBE-se dhe roli juaj personal në Shqipëri?**

Roli i Prezencës së OSBE-se në Shqipëri ka qenë shumë i fuqishëm dhe konstruktiv. Me sa e shoh unë ky rol tani është duke u bërë edhe më i rëndësishëm dhe konstruktiv. Sigurisht kohët janë duke u ndryshuar, por si rezultat i punës së shkelqyer që po bëjnë Prezenca në kemi fituar rolin tonë në proceset e vendit, por ky rol duhet fituar çdo javë. Për sa i përket rolit tim ai ka të bëjë me ruajtjen e një roli konstruktiv të pjesëmarrjes së Prezencës së OSBE-se në këto procese në mënyrë që perfundimi të jetë një produkt sa më i mirë që të jetë e mundur. Roli im gjithashtu ka të bëjë me mbajtjen e lidhjeve me qeverinë shqiptare dhe sa më shumë të jetë e mundur edhe me komunitetin ndërkombëtar në mënyrë që aktivitetet tona të jenë të harmonizuara.

**P: Cila ka qenë gjeja e parë që keni bërë pas mbërritjes në vendin tonë?**

Së pari degjova një rezultat që punojnë për mua. Pata prezantime shumë intensive dhe pas kësaj pata diskutime me Kryeministrin, Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Presidentin, Pata vertet prezantime shumë intensive për Shqipërinë dhe politikën në Shqipëri.

**P: Si jeton Ambasadori i OSBE-se në Shqipëri?**

Me duhet të them se ka qenë vetëm punë, punë dhe punë. Por puna me ka çuar edhe në shumë vende interesante në Shqipëri si dhe me ka takuar me shumë njëzëz interesante. Pra le të themi që koha ime e lirë kalohet në shumicën e rasteve në punë.

**P: Mund të na thoni diçka për familjen tuaj?**

Unë vij nga një familje me traditë patriotike, por nga një familje normale. Në të kaluarën brezi i prindërve të mi kanë patur shumë merita për vendin. Ka qenë një nga familjet me medaljet ushtarake më të larta, por nëse leme menjëherë këto gjëra në mbetemi një familje normale. Vëllai im ende është Kryeministri i Finlandës, por si edhe në familje të tjera normale në kemi pjesëtarë që janë të papunë dhe ata që kanë punë normale si dhe femije që studiojnë. Në kemi thjesht një jetë normale me gjithë vështirësitë dhe kënaqësitë e saj.

Gruaja ime Sheryl është Amerikane. Ajo ndodhet me mua këtu në Shqipëri. Në kemi tre femije, një në Finlandë dhe dy në Shtetet e Bashkuara.

**P: Cilat janë hobet tuaja dhe sa keni mundësi t'i realizoni ato në Shqipëri?**

Duhet të them se nuk kam kohë fare për hobi të mi në Tiranë. Në Zagreb, përpara se të vija këtu, vazhdoja të luaja hokej në akull, por sic e dini edhe ju në Tiranë nuk ka një ring akulli kështu që nuk mund të luaj. Kam marrë shumë plaje nga sportet që kam luajtur dhe prandaj nuk mund të vrapoj por mund të luaj hokej dhe kjo gjë më mungon këtu.

**P: Çfarë do të donit të bënit pas perfundimit të misionit diplomatik në Tiranë?**

Do të doja që të ishte diçka po kaq sfiduese dhe e rëndësishme ashtu si edhe puna ime këtu. Dhe kjo gjë është shumë e vështirë për t'u arritur. Megjithatë, unë kam shumë vite

ne karien time dhe varet nga shume faktore se ku do te shkoj. Ka shume mundesi qe te punoj si ambasador diku tjeter vetem ne se nuk do te marr ndonje detyre tjeter nderkombetare. Megjithese eshte paksa heret per te bere plane te tilla. Kjo pune qe kam tani eshte vertet sfiduese dhe vertet me pelqen.